



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

### GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA

---

**AD.GJTHM.nr.10/23**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICE**, Nënkryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj A.M Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtrri, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga avokati B.S nga Podujeva, pas vlerësimit të ankesës së parashtruar nga avokati B.S dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit A.M, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 17.10.2023, merre këtë;

#### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** Ankesa disiplinore e dt.22.09.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.10/2023, e parashtruar nga avokati B.S nga Podujeva, kundër Gjyqtarit A.M, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë– Dega në Vushtrri, Departamenti i përgjithshëm e **PA BAZUAR**.

#### **A r s y e t i m**

Në cilësinë e autoritetit kompetent të Gjykatës Themelore në Mitrovicë(ne rrethanat aktuale), me dt.22.09.2023 kemi pranuar ankesën nga avokati B.S nga Podujeva, e cila ankesa fillimisht i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kundër Gjyqtarit A.M, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm.

Avokati B.S me ankesë i është drejtuar Këshillit Gjyqësor lidhur me veprimet e gjyqtarit A.M, pasi ai si mbrojtës i të pandehurit F.Sh nuk është njoftuar me kërkesën e Prokurorisë për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe duke parë shqetësimin e familjarëve të pandehurve, detyrohet që një ditë para skadimit të kësaj mase ti shkruaj E-mail gjyqtarit A.M, me ç'rast i ka përkujtuar se nesër i skadon masa e paraburgimit dhe ka kërkuar të njoftohet nëse mund të shkojnë familjarët ta marrin të pandehurit në Qendrën e paraburgimit. Gjyqtari i çështjes përveç që nuk i është përgjigjur, ende nuk ka marrë aktvendimi për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe se klienti i tij është duke u mbajtur në mënyrë të kundërligjshme, pasi që sipas aktvendimit PPr.nr.59/23 të dt.27.07.2023 masa e paraburgimit do të duhej të skadojë me dt.26.08.2023.

Autoriteti kompetent në rastin konkret ka marrë veprime procedurale pas pranimit të ankesës, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj subjektit të hetimit-gjyqtarit i cili përmes E-maili-it lidhur me ankesën e avokatit B.S, ka cekë se nga i njëjti ka pranuar njoftimin për skadimin e masës së paraburgimit për të pandehurin F.Sh në procedurë paraprake, të cilin paraburgim e ka vazhduar brenda afatit ligjor. Sipas Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarin e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës janë paraparë mënyrat e dorëzimit të parashtrësve nga ana e palëve, ku parashtrësat dorëzohen fizikisht, përmes postës dhe sistemi elektronik ku lejohet qasja e tillë sipas ligjit dhe duhet të bëhet përmes Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve. Sa i përket njoftimit dhe dhënia e përgjegjës nuk është e lejuar dhe nuk konsiderohet dorëzim i rregull, për këtë arsye nuk ka dhënë përgjigje. Gjithashtu të gjitha aktet gjyqësor

të nxjerra nga gjyqtari dorëzohen tek palët nga ana e zyrtarit ligjor apo referentit që janë pjesë e administratës së gjykatës.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësi disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror janë të pa qëndrueshme, nuk kemi dyshim të qëndrueshëm për veprimet procedurale në raport me subjektin e hetimit duke marrë për bazë përgjigjen e marrë nga gjyqtari ndaj të cilës është ngritur procedura disiplinore, i cili i ka shpjeguar veprimet e ndërmarra, se në afat ligjor e ka vazhduar masën e paraburgimit, ndërsa vendime e nxjerra nga gjyqtari dorëzohen tek palët nga ana e zyrtarit ligjor dhe referentit të cilët janë përgjegjës për pranimin, regjistrimin dhe dorëzimin e tyre, andaj në një situatë të tillë nuk kemi shkelje disiplinore dhe ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Dispozitat e Rregullores për organizmin dhe veprimtarin e brendshme të gjykatave të Republikës së Kosovës, neni 26 përcakton se të gjitha parashtresat nga palët dorëzohen dhe pranohen në Gjykatë; përmes Zyrës për Menaxhimin e lendeve (ZML); Dorëzohen drejtpërsëdrejti nga palët; dorëzohen përmes shërbimit postare si dhe shërbimit elektronik, sistemit elektroni – kur lejohet çasja e tillë sipas ligjit dhe duhet të behet përmes Zyrës për Menaxhimin e lendeve në Gjykatë (ZML), neni 36 përcakton se pas përpilimit të vendimit gjyqësor gjyqtari e kthen lenden në ZML, në rastin konkretë kemi edhe çështjen në obligim të dispozitave ligjore nga neni 40 par.4 të Ligjit për Gjykatat ku gjyqtari nuk mund përfshihet në komunikim lidhur me lendet, mund të jone lëshime nga administrata në raste të caktuara, sipas obligimeve që rrjedhin nga rregullorja, por në asnjë rast nuk është në vullnetin e gjyqtareve në cenim të drejtës së palës dhe mbrojtësit për dorëzim të vendimeve dhe ushtrim të mjeteve juridike ndaj vendimeve gjyqësore.

Nga arsyet e theksuara më lartë, në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullore për Procedurën Disiplinore të Gjyqtareve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**AD.GJTHM.nr.10/2023, dt.17.10.2023**

**Nënkryetari i Gjykatës**  
**Bekim Veliqi**

**Aktvendimi i dërgohet;**

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës**
- 2. Parashtruesit Av.B.S**
- 3. Gjyqtari A.M**